



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM

Nr 107 Datë 11.12.2009

PER

Miratim fondi për Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës « Miratim fondi për Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit » bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008. "Për buxhetin e vitit 2009", Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» si dhe në VKB nr 12 dt 13.02.2009 " Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009" mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratoje kontributin financiar të Bashkisë me vlerën prej 200,000 lekësh.

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë, nga e cila 50,000 lekë do të përdoren për organizimin e koktejit dhe 150,000 lekë do të përdoren për blerje dhuratash dhe veshje për klientët e qendrës si dhe për plotësimin e nevojave të këtij institucioni në zërin shpenzime operative. me kete strukture buxhetore :

Pakësohet	00	04980	05	Art	6090000	- 200 000
Shtohet	00	10140	06	Art	6020000	+ 200 000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Gjergji Pendavinji